



# UDHËZUES PËR PARAQITJEN DHE SHQYRTIMIN E ÇËSHTJEVE NË GJYKATËN E LARTË



Financuar nga  
Bashkimi Evropian

**EURALIUS**  
Consolidation of the  
Justice System in Albania



**GJYKATA E LARTË**  
REPUBLIKES SË SHQIPËRISË

Botim i Gjykatës së Lartë,  
me ndihmën teknike të projektit EURALIUS V (Konsolidimi i Sistemit të  
Drejtësisë në Shqipëri).

Tiranë 2021

Desing & Layout: Grafika Elzana


*Ky botim është prodhuar me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian. Përmbajtja e tij është përgjegjësi e vetme e Gjykatës së Lartë të Republikës së Shqipërisë dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e Bashkimit Evropian*

EURALIUS  
Ministria e Drejtësisë  
Blvd Zogu I-rë  
Tiranë  
E-mail: [info@euralius.eu](mailto:info@euralius.eu)  
Web: [www.euralius.eu](http://www.euralius.eu)



# PËRMBAJTJE

|                                          |    |
|------------------------------------------|----|
| PARATHËNIE                               | 3  |
| TRUPAT GJYKUESE                          | 6  |
| LLOJET E REKURSEVE                       | 9  |
| REKURSET E VEÇANTA NË ÇËSHTJET<br>PENALE | 11 |
| REKURSI I ZAKONSHËM                      | 14 |
| NJOFTIMI I VENDIMEVE                     | 26 |
| FORMATI I REKURSIT                       | 28 |



**GJYKATA E LARTË**

REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

# PARATHËNIE

- Gjykata e Lartë e Republikës së Shqipërisë është instanca më e lartë ankimuese për çështjet civile, administrative dhe penale në Shqipëri, që gëzon kompetencën për të prishur (latinisht: “cassare”) vendimet e gjykatave më të ulëta.
- Roli i Gjykatës së Lartë si “Gjykatë Kasacioni” parashikohet nga Neni 141 i Kushtetutës<sup>1</sup> ku sanksionohet se Gjykata e Lartë shqyrton çështje lidhur me kuptimin dhe zbatimin e ligjit për të siguruar njësimin ose zhvillimin e praktikës gjyqësore, sipas ligjit. Pra, gjykimi kasacional nënkupton shfuqizimin e një vendimi gjyqësor mbi bazën e një mjeti ligjor. Gjykata nuk mund të vendosë zgjidhjen e ndryshme të çështjes duke marrë prova të reja, por ka të drejtë vetëm ta kthejë për gjykim çështjen në gjykatën kompetente, vendimi i së cilës shfuqizohet.
- Gjykata e Kasacionit shqyrton dhe analizon ligjin dhe rrethanat e çështjes vetëm për aq sa i nevojitet asaj për të interpretuar ligjin ose një koncept të së drejtës, pa bërë një shqyrtim të ri të fakteve dhe provave. Në këtë kuptim, funksioni i Gjykatës së Lartë sot është të kontrollojë nëse ligji është interpretuar dhe zbatuar në mënyrë korrekte nga gjykatat më të ulta, vendimi i të cilave kundërshtohet. Gjykata e Lartë nuk ka si thelb të veprimtarisë së saj shqyrtimin e fakteve dhe të provave në një çështje konkrete, por në raste të caktuara kjo mund të bëhet vetëm në lidhje dhe për aq sa ndihmon Gjykatën të interpretojë ligjin e zbatueshëm.

Ky udhëzues synon të informojë dhe qartësojë praktikantët e së drejtës për rregullat e paraqitjes dhe shqyrtimit të rekursit në Gjykatën e Lartë, duke mbajtur parasysh risitë që kanë sjellë ndryshimet kushtetuese të vitit 2016 si dhe ndryshimet ligjore në Kodin e Procedurës Civile, Penale dhe Ligjin për gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative të vitit 2021.

<sup>1</sup> Neni 141 paragrafi 1 i Kushtetutës (ndryshuar me ligjin nr.76/2016, datë 22.7.2016)

# TRUPAT

## TRUPAT GJYKUESE

Duke pasur parasysh rolin e rishikuar të Gjykatës së Lartë, risi në ndryshimet në procedurë është njësimi i përbërjes së trupit gjykues në Kolegjin Civil, Kolegjin Penal dhe Kolegjin Administrativ të Gjykatës së Lartë<sup>2</sup>. Kështu, në varësi të fazës se ku ndodhet shqyrtimi i dosjes apo i çështjeve që ngrihen për shqyrtim, përbërja e trupave gjykues varion, si më poshtë:

### NJË GJYQTAR I VETËM:


#### ■ **Plotësimin e të metave të rekursit në çështjet civile dhe administrative:**

- gjyqtari relator shqyrton rekursin e depozituar në lidhje me plotësimin e kushteve formale dhe afateve kohore sipas ligjit dhe vendos njoftimin e palëve për plotësimin e të metave; **në rast mosplotësimi relatori vendos kthimin e rekursit;**

#### Kërkesat për përjashtim gjyqtari:

- një gjyqtar i gjykatës, i ndryshëm nga gjyqtarët e kolegjit të cilit i përket gjyqtari që kërkohet të përjashtohet, vendos për kërkesën e përjashtimit të gjyqtarit, për çështjet civile, administrative dhe penale<sup>3</sup>.

### NJË GJYQTAR




2 Neni 31 Ligji për Pushtetin Gjyqësor (ndryshuar me ligjin nr.46/2021 datë 23.3.2021, neni 6)

3 Neni 75 KPC (ndryshuar me ligjin nr.44/2021 datë 23.3.2021, neni 6); Neni 21 pika 2 KPP (ndryshuar me ligjin nr.41/2021 datë 23.3.2021, neni 4)

## KOLEGJ ME TRUP GJYKUES TË PËRBËRË NGA 3 (TRE) GJYQTARË<sup>4</sup>

- Rekursët për të gjitha çështjet civile, administrative dhe penale që shqyrtohen në themel, si dhe ndaj vendimeve jopërfundimtare;
- Rekursët për masat e sigurimit në çështjet penale;
- Kërkesat për pezullimin e ekzekutimit të një vendimi civil apo administrativ, kërkesat për revokimin e vendimeve të pezullimit, kërkesat për gjykimin e çështjes tej afateve të arsyeshme, kërkesat për heqjen e dënimit administrativ me gjobë për rekurse apo kërkesa abuzive etj.
- Ankimet ndaj vendimeve për nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit, apo parashtrimet e gjykatave për ngritjen e mosmarrëveshjes së kompetencave.

### TRE GJYQTARË



## KOLEGJ ME TRUP GJYKUES TË PËRBËRË NGA 5 (PESE) GJYQTARË

- Rekursët në çështjet administrative e kundër vendimeve të Gjykatës Administrative të Apelit që kanë shqyrtuar padi ndaj aktit nënligjor normativ<sup>5</sup>;
- Rekursët që gjykohen në kuadër të njësimin dhe zhvillimit të praktikës gjyqësore<sup>6</sup>.

### PESE GJYQTARË



4 Neni 14/a KPP (ndryshuar me ligjin nr.41/2021 datë 23.3.2021, neni 2)

5 Neni 12 pika 3 LGJA (ndryshuar me ligjin nr.49/2021 datë 23.3.2021, neni 1)

6 Neni 31 Ligji për Pushtetin Gjyqësor (ndryshuar me ligjin nr.46/2021 datë 23.3.2021, neni 6); Neni 35 paragrafi 2 KPC (ndryshuar me ligjin nr.44/2021 datë 23.3.2021, neni 1); Neni 14/a KPP (ndryshuar me ligjin nr.41/2021 datë 23.3.2021, neni 2)

## KOLEGJET E BASHKUARA TË GJYKATËS SË LARTË

(mbledhja e të gjithë gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë)

### KOLEGJET E BASHKUARA TË GJYKATËS SË LARTË



Neni 141 i Kushtetutës<sup>7</sup> parashikon se “Për ndryshimin e praktikës gjyqësore, Gjykata e Lartë tërheq për shqyrtim në Kolegjet e Bashkuara çështje të caktuara gjyqësore të vendosura nga kolegjet, sipas ligjit”.

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, nënkupton Mbledhjen e Përbashkët të të gjithë gjyqtarëve të Kolegjit Civil, Kolegjit Penal dhe Kolegjit Administrativ. Me kërkesë të kolegjit ose të Kryetarit të Gjykatës së Lartë, mund të nisë procedura për ndryshimin e praktikës gjyqësore, kur konstatohet se është e nevojshme me qëllim zbatimin e drejtë të ligjit nga gjykatat më të ulëta.

### KUJDES:



Me ndryshimet kushtetuese të 2016, neni 141 i Kushtetutës është riformuluar, duke parashikuar kompetencën e Kolegjeve të Bashkuara për ndryshimin e praktikës dhe jo për njësimin e saj, siç ka qenë para ndryshimeve të vitit 2016. Arsyeja për këtë qëndron në faktin se në thelb, vendimi i çdo kolegji të Gjykatës së Lartë është një vendim detyrues për gjykatat më të ulta dhe ka për qëllim konsolidimin dhe qëndrueshmërinë e praktikës gjyqësore.

<sup>7</sup> Neni 141 paragrafi 2 i Kushtetutës (ndryshuar me ligjin nr.76/2016, datë 22.7.2016)

# LLOJET E REKURSEVE



“Rekursi zakonshëm”:

- paraqitet kundër një vendimi në themel të gjykatës së apelit.

“Rekursi i veçantë”:

- paraqitet kundër vendimeve jopërfundimtare, si dhe vendime të ndërmjetme të gjykatave më të ulta.

## REKURSET E VEÇANTA NË ÇËSHTJET CIVILE DHE ADMINISTRATIVE

- Një nga risitë e ndryshimeve ligjore ka qenë rregullimi i rolit të Gjykatës së Lartë në çështjet e juridiksionit dhe kompetencës, në drejtim të harmonizimit të parashikimeve procedurale në të drejtën civile dhe administrative si dhe të rritjes së efikasitetit të procedimeve gjyqësore.

NJË NGA RISITË  
E NDRYSHIMEVE  
LIGJORE KA QENË  
RREGULLIMI I ROLIT  
TË GJYKATËS SË  
LARTË NË ÇËSHTJET  
E JURIDIKSIONIT DHE  
KOMPETENCËS

## JURIDIKSIONI

- Duke ndjekur modelin e nenit 9 të Ligjit për Gjykimin Administrativ<sup>8</sup>, tashmë rekurs i veçantë lejohet vetëm ndaj vendimit jopërfundimtar të gjykatës civile që nxjerr çështjen jashtë juridiksionit të saj. Ky rregullim i ri u imponua nga fakti se kjo vendimarrje potencialisht mund të shkaktojë cenimin në thelb të aksesit në drejtësi për individin.
- Ndryshe paraqitet çështja e vendimit të ndërmjetëm të gjykatës që vendos ta konsiderojë çështjen në juridiksionin gjyqësor, pasi nuk ka cenim flagrant të aksesit në drejtësi dhe se kjo çështje mund të shqyrtohet si pjesë e ankimit. Për rrjedhojë ndaj vendimit të ndërmjetëm të gjykatës civile që rrëzon kërkesën e palës për nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit nuk mund të bëhet rekurs i veçantë.

## (MOS)KOMPETENCA

- E njëjta logjikë ligjore është ndjekur në lidhje me ushtrimin e ankimit ndaj vendimit gjyqësor që ka shpallur moskompetencën për gjykimin e mosmarrëveshjes, si dhe kundër vendimit për rrëzimin e kërkesës për shpalljen e moskompetencës. Ndaj është parashikuar që për çdo disponim mbi kompetencën të lejohet vetëm ankim sipas rregullave të zakonshme të ankimit dhe jo rekurs i veçantë<sup>9</sup>.
- Gjykata e Lartë në vendimin e saj për rregullimin e kompetencës jep udhëzimet e nevojshme për procesin gjyqësor të zhvilluar dhe për vazhdimin e tij nga gjykata që deklarohet kompetente<sup>10</sup>.

<sup>8</sup> Ligi nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar

<sup>9</sup> Neni 62 KPC

<sup>10</sup> Neni 16 KPC (ndryshuar me ligjin nr.44/2021 datë 23.3.2021, neni 5)

## VENDIMI PËR KTHIMIN E REKURSI TË GJYQTARIT TË VETËM TË GJYKATËS SË LARTË

Kundër vendimit të gjyqtarit të vetëm të Gjykatës së Lartë për kthimin e rekursit për mosplotësim/korrigjim të të metave të rekursit nuk lejohet ankim<sup>11</sup>.

## RASTET E TJERA KUR PARAQITET REKURSI I VEÇANTË

**Në çështjet civile**, rekursi i veçantë mund të paraqitet edhe kundër

- vendimit të gjykatës së apelit për prishjen e vendimit të gjykatës së shkallës së parë dhe pushimin e çështjes<sup>12</sup>;
- vendimit të gjykatës së apelit për prishjen e vendimit të gjykatës së shkallës së parë, tërësisht ose pjesërisht dhe dërgimin e çështjes për rigjykim<sup>13</sup>;

## AFATET DHE MËNYRA E SHQYRTIMIT TË REKURSI TË VEÇANTË

### KUJDES:



Afat për paraqitjen e rekurseve të veçanta kundër vendimeve jopërfundimtare ka ndryshuar dhe është 5 ditë<sup>14</sup>.

**5**  
DITË

Gjykata e Lartë i shqyrton rekursin e veçantë brenda 30 ditëve në dhomë këshillimi me trup gjykues të përbërë nga 3 (tre) gjyqtarë.

<sup>11</sup> Neni 476 (ndryshuar me ligjin nr.44/2021 datë 23.3.2021, neni 15); Neni 60 (ndryshuar me ligjin nr.49/2021)

<sup>12</sup> Neni 466 KPC (ndryshuar me ligjin nr.44/2021 datë 23.3.2021, neni 14)

<sup>13</sup> Neni 467 KPC (ndryshuar me ligjin nr.44/2021 datë 23.3.2021, neni 15)

<sup>14</sup> Neni 443 KPC (ndryshuar me nr.44/2021 datë 23.3.2021, neni 11)

# REKURSET E VEÇANTA NË ÇËSHTJET

## REKURSET E VEÇANTA NË ÇËSHTJET PËNALE

- **Në çështjet penale**, është parashikuar ushtrimi i ankimit kundër vendimit për kërkesën e përjashtimit të gjyqtarit së bashku me vendimin përfundimtar, duke hequr mjetin e rekursit të veçantë dhe duke mundësuar që Gjykata e Lartë të jetë më operative në gjykimin e çështjeve<sup>15</sup>.

### KUJDES:



Rregullimet e reja kanë vendosur sanksione ndaj subjektit që parashtron kërkesa të padrejta dhe të papranueshme për përjashtimin e gjyqtarit. Subjekti detyrohet të paguajë shpenzimet gjyqësore përkatëse, si dhe një gjobë deri në 50 000 lekë<sup>16</sup>.

<sup>15</sup> Neni 21 pika 2 KPP (ndryshuar me ligjin nr.41/2021 datë 23.3.2021, neni 4)

<sup>16</sup> Neni 22/a KPP (shtuar me ligjin nr.41/2021 datë 23.3.2021, neni 6)

## PEZULLIMI I EKZEKUTIMIT TË VENDIMIT

- **Në çështjet civile** është rregulluar problematika e mbivendosjes së kompetencës midis gjykatës së apelit dhe Gjykatës së Lartë lidhur me pezullimin e ekzekutimit të vendimit, duke shfuqizuar paragrafin e dytë të nenit 469<sup>17</sup> dhe duke ia lënë këtë kompetencë vetëm Gjykatës së Lartë<sup>18</sup>.
- **Në çështjet penale** janë parashikuar ndryshime mbi pezullimin e ekzekutimit të vendimit, duke sanksionuar se vendimi mund të pezullohet nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, vetëm në rastet e mëposhtme<sup>19</sup>:
  - kur i dënuari vuan nga një sëmundje që pengon ekzekutimin e vendimit (ekzekutimi shtyhet deri në shërimin e të dënuarit);
  - kur e dënuara është shtatzënë ose me fëmijë nën një vjeç (ekzekutimi shtyhet derisa fëmija të bëhet një vjeç);
  - kur vuajtja e menjëhershme e dënimit mund të sjellë pasoja të rënda për të dënuarin ose familjen e tij (shtyrja e ekzekutimit në këto raste nuk mund të zgjatet më tepër se gjashtë muaj);
  - në çdo rast tjetër që çmohet nga gjykata si i veçantë, duke u shtyrë ekzekutimi gjer në tre muaj<sup>20</sup>.

17 Neni 469 KPC (shfuqizuar me ligjin nr.44/2021 datë 23.3.2021, neni 16)

18 Neni 479 KPC

19 *Shih* pikën 1 të nenit 476 KPP

20 Neni 417 KPP (ndryshuar me ligjin nr.41/2021 datë 23.3.2021, neni 22)

# REKURSI I ZAKONSHËM

## 1. Shkaqet për rekurs

- Shkaqet e rekursit që parashikohen në ligjet procedurale nuk kanë qenë objekt i ndryshimeve ligjore. KPC<sup>21</sup>, KPP<sup>22</sup> dhe LGjA<sup>23</sup> parashikojnë shkaqet për rekurs në Gjykatën e Lartë, të cilat mund të grupohen si më poshtë:
  - për mosrespektimin ose për zbatim të gabuar të ligjit material ose procedural, të një rëndësie themelore për njësimin, sigurinë dhe/ose zhvillimin e praktikës gjyqësore;
  - kur vendimi i ankimuar është i ndryshëm ose vjen në kundërshtim me praktikën gjyqësore të Kolegjit përkatës ose të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë;
  - për shkelje të rënda të normave procedurale me pasojë pavlefshmërinë e vendimit, të procedurës së gjykimit, pavlefshmërinë absolute të akteve ose papërdorshmërinë e provave, sipas ligjit.

21 Neni 472 KPC (ndryshuar me ligjin nr. 38/2017, neni 96)

22 Neni 432 KPP

23 Neni 58 LGjA (ndryshuar me ligjin nr.39/2017, neni 5)

## 2. Depozitimi i rekursit

- Ndryshimi i procedurave që duhen ndjekur për depozitimin e rekursit përbën një nga risitë e ndryshimeve ligjore. Thelbi i këtyre ndryshimeve lidhet me detajimin e hapave procedurale, duke përfshirë sqarimin e paqartësive që kanë ekzistuar në lidhje me plotësimin e të metave të rekursit në Gjykatën e Lartë.

### KUJDES:

Rekursi depozitohet në gjykatën që ka dhënë vendimin (pra Gjykata Administrative e Apelit dhe jo në gjykatën administrative të shkallës së parë.



- Me qëllim harmonizimin e parashikimeve procedurale dhe orientimin e palëve në paraqitjen e rekursit është ndjekur qasja e nenit 475 të KPC, duke parashikuar elementet që duhet të përmbajë rekursi në procedurat penale<sup>24</sup> dhe administrative<sup>25</sup>.
- Rekursi hartohet sipas formatit të miratuar nga Këshilli i Gjykatës së Lartë. Formatu ka karakter jodetyrues dhe synon të lehtësojë hartimin e një rekursi në mënyrë sa më të plotë dhe të qartë. Në çdo rast, rekursi duhet të përmbajë jo vetëm shkaqet për të cilat kundërshtohet vendimi i dhënë, por edhe argumentet që mbështesin pretendimin se ekzistojnë domosdoshmërisht shkaqet për rekurs që ligji përcakton shprehimisht. (Formati tip i hartimit të rekursit bashkëlidhur në fund të këtij udhërrëfyesi).

### KUJDES:


Ndryshime janë kryer edhe lidhur me nënshkrimin e rekursit, duke parashikuar nënshkrimin nga avokati jo vetëm të rekursit, por edhe të kërkesave të tjera që paraqiten në Gjykatën e Lartë<sup>26</sup>.



24 Neni 434/a paragrafi 1 KPP (shtuar me ligjin nr.41/2021 datë 23.3.2021, neni 28)

25 Neni 56/a paragrafi 1 LGJA (shtuar me ligjin nr.49/2021 datë 23.3.2021, neni 4)

26 Neni 20 KPC (ndryshuar me ligjin nr.44/2021 datë 23.3.2021, neni 20)



BRENDA  
**30**  
DITËVE

## ÇËSHTJET CIVILE DHE ADMINISTRATIVE

- Rekursi së bashku me dokumentet e tjera të nevojshme të parashikuara në ligj depozitohet në sekretarinë e gjykatës që ka dhënë vendimin **brenda 30 ditësh** nga njoftimi i vendimit.
- Rekursuesi ka disa mundësi për të plotësuar/korrigjuar të metat e rekursit:
  - Kur rekursi nuk plotëson kushtet e parashikuara në ligj (pra nuk është nënshkruar ose nuk është paraqitur në përputhje me kërkesat ligjore), gjyqtari relator i Gjykatës së Lartë, të cilit i është caktuar çështja për shqyrtim, njofton palën për të plotësuar të metat e rekursit;
  - Afati për të plotësuar/korrigjuar të metat është 5 ditë;
  - Çështja shqyrtohet nga gjyqtari i vetëm në dhomë këshillimi.

- Në rast se rekursuesi nuk plotëson ose korrigjon të metat brenda afatit, gjyqtari vendos kthimin e rekursit.
- Kur të metat e rekursit janë plotësuar në afatin caktuar, rekursi konsiderohet formalisht i rregullt dhe i regjistruar në datën e depozitimit në gjykatë.

## ÇËSHTJET PENALE

- Rekursi së bashku me dokumentet e tjera të nevojshme të parashikuara në ligj depozitohet në sekretarinë e gjykatës që ka dhënë vendimin **brenda 45 ditësh** nga njoftimi i vendimit.
  - Kur rekursi ka mangësi (pra, nuk është nënshkruar ose nuk është paraqitur në përputhje kërkesat ligjore) Gjykata e Lartë njofton palën për të plotësuar të metat e rekursit.
  - Në rast se rekursuesi nuk plotëson ose korrigjon të metat, Kolegji Penal vendos mospranimin e rekursit.
  - Kur të metat e rekursit janë plotësuar, rekursi konsiderohet formalisht i rregullt dhe i regjistruar në datën e depozitimit në gjykatë.

BRENDA  
**45**  
DITËSH

### 3. Shqyrtimi i rekursit

#### MËNYRA E SHQYRTIMIT (DHOMË KËSHILLIMI/ SEANCË GJYQËSORE)

Një tjetër risi ndryshimeve ligjore procedurale të vitit 2021 lidhet me shqyrtimin e rekurseve në Gjykatën e Lartë. Si rregull, shqyrtimi i çështjes bëhet në dhomë këshillimi mbi bazë dokumentesh, pa praninë e palëve<sup>27</sup>. Për rrjedhojë gjykimi në seancë publike bëhet në raste të veçanta kur:

- a) Çështja paraqet rëndësi nga pikëpamja e së drejtës për njësimin ose zhvillimin e praktikës gjyqësore;
- b) Vlerësohet e nevojshme nga kolegji thirrja dhe dëgjimi i palëve për shkak të problematikës ose kompleksitetit të çështjes<sup>28</sup>.
- c) Shqyrtohet rekursi ndaj vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit lidhur me ligjshmërinë e aktit nënligjor normativ.

Vendimi për shqyrtimin e çështjes në seance gjyqësore merret në dhomë këshillimi nga kolegji përkatës i përbërë nga 3 gjyqtarë.

27 Neni 482 KPC (ndryshuar me ligjin nr.44/2021 datë 23.3.2021, neni 24); Neni 436/a KPP (shtuar me ligjin nr.41/2021 datë 23.3.2021, neni 32); Neni 61 paragrafi 1 LGJA

28 Neni 62, pika 1 i LGJA (ndryshuar me ligjin nr.49/2021, datë 23.3.2021 neni), neni 482 i KPC (ndryshuar me ligjin nr.44/2021 datë 23.3.2021, neni 25); neni 437, pika 1 (ndryshuar me ligjin nr.41/2021 datë 23.3.2021, neni 33)

## AFATI I SHQYRTIMIT

Afati i shqyrtimit në **çështjet civile** është 60 ditë nga depozitimi i rekursit.

Afati i shqyrtimit në **çështjet administrative** është 90 ditë nga data e ardhjes së rekursit. Afati për shqyrtimin e rekursit ndaj vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit lidhur me gjykimin e aktit nënligjor normativ, është 45 ditë<sup>29</sup>.

Afati i shqyrtimit në **çështjet penale** është jo më vonë se 2 muaj nga momenti i regjistrimit në sekretarinë gjyqësore<sup>30</sup>.

## CAKTIMI I DATËS SË SHQYRTIMIT

Data dhe ora e shqyrtimit të çështjes në dhomë këshillimi vendoset nga gjyqtari relator, ndryshe nga më parë kur caktohej nga kryetari i kolegjit. Po kështu, tashmë palët mund të kërkojnë me shkrim pranë gjyqtarit relator përshpejtimin e shqyrtimit të çështjes për shkaqe veçanërisht të rënda dhe të motivuara, kur një gjë e tillë nuk vjen në kundërshtim me ligjin.

## NJOFTIMI PËR SHQYRTIMIN

Data, ora, si dhe përbërja e trupit gjykues që shqyrton rekursin bëhet me njoftim individual, kur palët ose përfaqësuesit e tyre kane lënë të dhënat e tyre elektronike të kontaktit në shkallët e tjera të gjyqimit, si dhe me shpallje në mjediset dhe faqen e zyrtare të internetit të Gjykatës së Lartë.

29 Neni 60 i GJLA (ndryshuar me ligjin nr.49/2021 datë 23.3.2021, neni 6)

30 Neni 435, pika 1 i KPP (shtuar me ligjin nr.41/2021 datë 23.3.2021, neni 33)

#### 4. E drejta për të depozituar parashtrësia për çështjet e ligjit

- Një tjetër parashikim i ri ligjor është edhe rrethana kur Gjykata e Lartë vë në themel të vendimit çështje ligjore, të cilat merren në shqyrtim kryesisht dhe palët nuk i kanë debatuar më parë. Në këto raste:
  - urdhërohet njoftimi i palëve, i cili kryhet sipas rregullave të përgjithshme;
  - u caktohet palëve një afat për depozitimin në sekretari të parashtrësive mbi atë çështje të së drejtës, dhe
  - vetëm më pas procedohet me shqyrtimin e çështjes.
- Ky parashikim u jep mundësi palëve që të debatojnë dhe të mbrohen para se të gjykohen, në përputhje me parashikimet e nenit 33 dhe 42 të Kushtetutës, si dhe nenit 6 të.<sup>31</sup>

<sup>31</sup> Neni 473/a paragrafi 2 KPC (shtuar me ligjin nr.44/2021 datë 23.3.2021, neni 19); Neni 434 paragrafi 3 KPP (shtuar me ligjin nr.41/2021 datë 23.3.2021, neni 27); 31 Neni 434 paragrafi 3 KPP (shtuar me ligjin nr.41/2021 datë 23.3.2021, neni 27)

## 5. Heqja dorë nga rekursi

Sipas parimit të disponibilitetit në procesin gjyqësor, pala që investon gjykatën, mund të heqë dorë në çdo kohë nga gjykimi i çështjes. Duke mbajtur në konsideratë këtë parim, është parashikuar se pala mund të heqë dorë nga rekursi derisa kolegji përkatës apo Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë nuk janë tërhequr për vendim<sup>32</sup>. Heqja dorë bëhet me shkrim, e nënshkruar nga vetë pala ose avokati i saj, i pajisur me prokurë për këtë qëllim.

Përpara ndryshimeve ligjore, parashikohej se rekursi mundet të tërhiqej derisa nuk ishte filluar relatiimi në seancë gjyqësore.

### GJYKIMI PËR NJËSIMIN OSE NDRYSHIMIN E PRAKTIKËS GJYQËSORE

Gjykata e Lartë, në përputhje edhe me nenin 141 të Kushtetutës, kujdeset për zbatimin dhe interpretimin e njësuar të ligjit.

**Njësimi i praktikës gjyqësore** mund të iniciohet nga kolegji përkatës, kryesisht ose me kërkesë të palëve<sup>33</sup>.

**Ndryshimi i praktikës gjyqësore** mund të inicohet nga kolegji ose Kryetari i Gjykatës së Lartë, kryesisht ose me kërkesë të palëve. Vendimi i ndërmjetëm i kolegjit ose i Kryetarit të Gjykatës së Lartë për kalimin e çështjes në seancë gjyqësore përcakton çështjet e shtruar për ndryshim të praktikës gjyqësore.

32 Neni 490 KPC (ndryshuar me ligjin nr.44/2021 datë 23.3.2021, neni 29)

33 Neni 481 KPC (ndryshuar me ligjin nr.44/2021 datë 23.3.2021, neni 23); Neni 62/a LGJA (shtuar me ligjin nr.49/2021 datë 23.3.2021, neni 10); Neni 438 KPP (ndryshuar me ligjin nr.41/2021 datë 23.3.2021, neni 34)

## KUJDES:



Procedurat për njësimin dhe ndryshimin e praktikës gjyqësore janë thelbësisht të ndryshme. Por, vendimi i kolegjit dhe/ose Kolegjeve të Bashkuara për njësimin ose ndryshimin e praktikës gjyqësore është i detyrueshëm për të gjithë gjykatat në gjykimin e çështjeve të ngjashme. Këto vendimeve botohen në Fletoren Zyrtare.

- Një nga risitë e ndryshimeve ligjore lidhet me parashikimin se për shkak të interesit që paraqet njësimi ose ndryshimi i praktikës gjyqësore, kur është rasti, Gjykata e Lartë mund të kërkojë mendim me shkrim nga Avokatura e Shtetit, si dhe nga persona juridikë publikë ose privatë që çmohet se kanë njohuri të posaçme për çështjet ligjore të shtruara për njësim ose ndryshim të praktikës gjyqësore.
- Gjykata e Lartë, në kërkesën për paraqitjen e mendimit me shkrim, cakton një afat brenda të cilit mund të paraqitet mendimi, në çdo rast jo më pak se 14 ditë. Mendimet me shkrim nuk janë detyruese dhe publikohen në faqen elektronike të Gjykatës së Lartë.
- Ky parashikim synon të ndihmojë Gjykatën e Lartë në dhënien e zgjidhjeve të përshtatshme për çështjet ligjore të shtruara për njësim ose zhvillim të praktikës gjyqësore, duke marrë edhe mendimin e subjekteve të ndryshme që kanë njohuritë dhe ekspertizën e duhur në lidhje me to, nisur nga lloji i veprimtarisë apo detyrave që kryejnë.

## PROCEDIMET PARAGJYKIMORE

- Një tjetër risi e ndryshimeve ligjore është parashikimi i procedimeve paragjykimore. Kjo lloj procedure përfshin rastet kur gjatë shqyrtimit të çështjes kolegji ose Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, në dhomë këshillimi ose në seancë gjyqësore, mund të vendosin t'i drejtohen GjEDNJ-së ose gjykatave të tjera ndërkombëtare sipas detyrimeve që rrjedhin nga marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë<sup>34</sup>.
- Në këto raste, kolegji ose Kolegjet e Bashkuara vendosin pezullimin e shqyrtimit të çështjes. Vendimi i pezullimit zgjat deri në marrjen e vendimit nga gjykata ndërkombëtare.

## DISPONIMI ME VENDIM I GJYKATËS SË LARTË

Një tjetër risi e ndryshimeve ligjore është **ndryshimi i përmbajtjes së disponimit** të Gjykatës së Lartë. Ky ndryshim synon të qartësojë llojet e vendimmarrjeve të Gjykatës së Lartë. Risia qëndron në zgjerimin e gamës së disponimeve të Gjykatës dhe harmonizimit të vendimmarrjes në çështjet civile, penale dhe administrative.

### KUJDES:



Kolegji përkatës ose Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, pas shqyrtimit të çështjes, mund të vendosë<sup>35</sup>:

34 Neni 483/a KPC (shtuar me ligjin nr.44/2021 datë 23.3.2021, neni 26); Neni 438/a KPP (shtuar me ligjin nr.41/2021 datë 23.3.2021, neni 35)

35 Neni 485 KPC (ndryshuar me ligjin nr.44/2021 datë 23.3.2021, neni 27); Neni 63 LGjA (ndryshuar me ligjin nr.49/2021 datë 23.3.2021, neni 11); Neni 441 KPP (ndryshuar me ligjin nr.41/2021 datë 23.3.2021, neni 36)



- mospranimin e rekursit, në rastet kur është bërë për shkaqe të ndryshme nga ato që parashikon ligji;
- prishjen e vendimit të gjykatës së apelit dhe lënien në fuqi të vendimit të gjykatës të shkallës së parë;
- prishjen e vendimit të gjykatës së apelit dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim në këtë gjykatë me tjetër trup gjykses;
- prishjen e vendimeve të gjykatës së apelit dhe të gjykatës të shkallës së parë dhe dërgimin e çështjes për rigjykim në shkallë të parë, kur vendimi jopërfundimtar i gjykatës së shkallës së parë është marrë në kundërshtim me ligjin dhe kjo shkelje nuk është konstatuar nga gjykata e apelit;
- prishjen e vendimit të gjykatës së shkallës së parë dhe të gjykatës së apelit dhe pushimin e gjykimit të çështjes;
- ndryshimin e vendimit të shkallës së parë dhe të vendimit të gjykatës së apelit dhe zgjidhjen përfundimisht të çështjes, kur zbatimi i ligjit procedural apo material nuk diktohet nga nevoja për rishqyrtimin dhe rivlerësimin e fakteve apo të provave të çështjes;
- lënien në fuqi të vendimit të apelit.

- Vlen të theksohet që parashikimi i ‘ndryshimit të vendimit të shkallës së parë dhe të vendimit të gjykatës së apelit dhe zgjidhjen përfundimisht të çështjes’ nuk duhet kuptuar si një vendimarrje që e ‘shndërron Gjykatën e Lartë në një gjykatë fakti’. Kjo lloj vendimarrje duhet kuptuar si një drejtë e kufizuar e Gjykatës për të zgjidhur përfundimisht çështjen me qëllim shmangien e zvarritjeve të panevojshme të qytetarëve në kërkim të drejtësisë. Prandaj, në raste përjashtimore, pa qenë e nevojshme marrja e provave të reja ose rishqyrtimi apo rivlerësimi i tyre, me qëllim zbatimin e njësuar të ligjit material ose procedural, çështja zgjidhet në një mënyrë të ndryshme nga sa është vendosur nga gjykatat më të ulta.

## KUJDES:



Kur Gjykata vendos dërgimin e çështjes për rigjykim, në vendim përcaktohet se cila pjesë e vendimit ose gjykimit të faktit prishet dhe për cilën pjesë të mosmarrëveshjes duhet të zhvillohet rigjykimi. Rigjykimi i çështjes pas prishjes së vendimit kufizohet vetëm në shkaqet e prishjes së vendimit. Pjesët e pacenuara të vendimit apo gjykimit nga gjykata me e lartë nuk rishqyrtohen<sup>36</sup>. Pas prishjes dhe kthimit për rigjykim, gjykata e faktit shqyrton gjithmonë nga e para çështjen, duke lejuar ndryshimin e objektit të padisë apo shkakut ligjor, ndryshimin e ndërgjyqësisë, ose duke përsëritur plotësisht shqyrtimin gjyqësor, edhe për çështjet të cilat në gjykim apo vendim nuk janë cenuar nga gjykata më e lartë.

<sup>36</sup> Neni 493 KPC (ndryshuar me ligjin nr.44/2021 datë 23.3.2021, neni 30)



# NJOFTIMI I VENDIMEVE

## NJOFTIMI I VENDIMEVE

Risi tjetër është parashikimi i detyrimit të njoftimit të vendimeve të Gjykatës së Lartë<sup>37</sup>. Mosnjoftimi i vendimeve të Gjykatës ka qenë një problematikë që gjeti zgjidhje me ndryshimet e reja ligjore.

Si rrjedhojë e këtij ndryshimi, çdo palë ose pjesëmarrës në proces njoftohet rregullisht për vendimin e Gjykatës. Afati i njoftimit për vendimet civile dhe administrative është 3 ditë nga marrja e vendimit ose në rast se vendimi i arsyetuar shpallet

<sup>37</sup> Neni 485/b KPC (ndryshuar me ligjin nr.44/2021 datë 23.3.2021, neni 28)

më vonë, brenda tre ditëve pas shpalljes së vendimit të arsyetuar<sup>38</sup>.

Ndryshimi ligjor është në funksion të garantimit të së drejtës së individit për akses tek mjetet e tjera të ankimit, siç është Ankimi Kushtetues Individual, sipas nenit 131/ç të Kushtetutës.

**3**

**DITË NGA MARRJA  
E VENDIMIT**

Vendimi për shfuqizimin e aktit nënligjor normativ, pas përfundimit të gjykimit në Gjykatën e Lartë, publikohet i plotë në të njëjtën mënyrë me atë të parashikuar nga legjislacioni në fuqi për botimin e aktit<sup>39</sup>.

38 Neni 485/b i KPC (ndryshuar me ligjin nr.44/2021 datë 23.3.2021, neni 28) parashikon zbatimin e përcaktimeve të nenit 316 të KPC.

39 Neni 43 paragrafi 3 LGjA (ndryshuar me ligjin nr.49/2021 datë 23.3.2021, neni 2)

# REKURS

**Paditës / Prokuroria:** \_\_\_\_\_

**I Paditur / I Pandehur:** \_\_\_\_\_

i përfaqësuar me prokurë nga Av. \_\_\_\_\_

**Objekti / Akuza:** \_\_\_\_\_

## A. BAZA LIGJORE

Neni 472 i KPC / Neni 58 i LGJA / Neni 432 i KPP

## B. PARAQITJA E RRETHANAVE TË ÇËSHTJES

*(Paraqisni në mënyrë të përmbledhur rrethanat e çështjes, pa përfshirë shkaqet e rekursit)*

---

---

---

---

## C. VENDIMET E GJYKATAVE

**I. VENDIMI I GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË** \_\_\_\_\_  
*(Citoni dispozitivin e vendimit)*

---

---

---

**II. SHKAQET E ANKIMIT NË GJYKATËN E APELIT** \_\_\_\_\_  
(Renditni në mënyrë të përmbledhur shkaqet e ankimit)

---

---

---

**III. VENDIMI I GJYKATËS SË APELIT** \_\_\_\_\_  
(Citoni dispozitivin e vendimit)

---

---

---

**D. SHKAQET E REKURSIT**

*(Parashtroni shkaqet e rekursit, sipas natyrës dhe llojit të shkeljes)*

**I. Zbatimi i gabuar i ligjit procedural të një rëndësie themelore për njësimin, sigurinë dhe/ose zhvillimin e praktikës gjyqësore;**

*[Paraqisni shkeljet e pretenduara të dispozitave konkrete procedurale të kryera nga gjykatat më të ulta, duke argumentuar mjaftueshëm rëndësinë që ka shkelja e konstatuar në funksion të nevojës për njësimin, zhvillimin apo ndryshimin e praktikës gjyqësore të Gjykatës së Lartë. Citoni në mbështetje të argumentave tuaja dhe vendime të tjera të Gjykatës së Lartë, të Gjykatës Kushtetuese, të GJEDNJ dhe të gjykatave ndërkombëtare, ose akte ndërkombëtare, të cilat trajtojnë ose kanë lidhje me natyrën a llojin e shkeljes procedurale të pretenduar, duke paraqitur informacion të saktë lidhur me burimin nga ku është marrë].*

---

---

---

---

## **II. Zbatimi i gabuar i ligjit material të një rëndësie themelore për njësimin, sigurinë dhe/ose zhvillimin e praktikës gjyqësore;**

*(Evidentoni shkeljet e kryera nga ana e gjykatave më të ulta lidhur me mënyrën e interpretimit apo zbatimit të gabuar të dispozitave materiale, duke argumentuar mjaftueshëm rëndësinë që ka shkelja e konstatuar në funksion të nevojës për njësimin, zhvillimin apo ndryshimin e praktikës gjyqësore të Gjykatës së Lartë. Citoni në mbështetje të argumenteve tuaja dhe vendime të tjera të Gjykatës së Lartë, të Gjykatës Kushtetuese, të GJEDNJ dhe të gjykatave ndërkombëtare, ose akte ndërkombëtare, të cilat trajtojnë ose kanë lidhje me natyrën a llojin e shkeljes së ligjit material të pretenduar, duke paraqitur informacion të saktë lidhur me burimin nga ku është marrë).*

---

—

---

—

## **III. Shmangia nga praktika e kolegjit/kolegjeve të bashkuara**

---

*(Argumentoni mospërputhjen ose shmangien e vendimit objekt kundërshtimi nga praktika gjyqësore e njësuar e kolegjit/ Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.*

---

---

---

---

#### IV. Shkeljet e rënda të normave procedurale, me pasojë pavlefshmërinë e vendimit, të procedurës së gjykimit, ose pavlefshmërinë e provave

*[Paraqisni argumente në favor të pretendimit se vendimi i gjykatave më të ulta është marrë si pasojë e shkeljeve të rënda procedurale, të tilla që sjellin si pasojë pavlefshmërinë e vendimit ose të procesit të gjykimit (KPC/LGJA), (apo pavlefshmërinë absolute të akteve ose papërdorshmërinë e provave të marra gjatë gjykimit - KPP)].*

---

---

---

---

#### E. OBJEKTI I REKURSIT

Në përfundim, duke vlerësuar se vendimet e gjykatave janë marrë (në shkelje të nenit \_\_\_\_ të KPC/LGJA/KPP/) (në interpretim dhe zbatim të gabuar të nenit \_\_\_\_ të Kodit \_\_\_\_\_ / ose të ligjit nr. \_\_\_\_\_, datë \_\_\_\_/\_\_\_\_/\_\_\_\_),

**Kërkojmë nga Gjykata e Lartë:**

---

---

---

**AVOKATI / PROKURORI**

---

(emri mbiemri nënshkrimi)



## GJYKATA E LARTË

REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata e Lartë  
Rr. Ibrahim Rugova, Nr.20  
1001 Tiranë  
Tel. +355 42257302  
email: [ida.vodica@gjykataelarte.gov.al](mailto:ida.vodica@gjykataelarte.gov.al)  
[supremecourt@gjykataelarte.gov.al](mailto:supremecourt@gjykataelarte.gov.al)  
[www.gjykataelarte.gov.al](http://www.gjykataelarte.gov.al)



Financuar nga  
Bashkimi Evropian

**EURALIUS**  
Consolidation of the  
Justice System in Albania

